

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë,

Së pari më lejoni të ju falënderoj për praninë tuaj në këtë konferencë të fund vitit dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe efektiv që kemi kultivuar ndër vite me qëllim të informimit sa më të drejtë të publikut rreth aktivitetit të BQK-së, si dhe zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend.

Komunikimi me mediat vazhdon të jetë pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e aktivitetit të BQK-së. Përmes raportimit të drejtë nga ana juaj, ne kemi arritur që ta mbajmë publikun të mirë informuar rreth zhvillimeve në sistemin financiar dhe ekonominë e vendit. Prandaj, dëshiroj që të shfrytëzoj rastin për të ju shprehur vlerësimin tim të lartë për profesionalizmin e treguar edhe gjatë këtij viti.

Me gjithë vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar, unë jam i lumtur që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur edhe këtë vit të zbatojë objektivat e saj, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, i cili këto vitet e fundit, arriti të përballojë me sukses krizat e shkaktuara nga pandemia Covid 19 e tani edhe agresioni rus në Ukrainë, por edhe të jetë një nga shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët, dhe me këtë edhe të ekonomisë së vendit.

Tani, më lejoni që para jush të paraqes një përmbledhje të zhvillimeve që karakterizuan ekonominë dhe sistemin financiar të vendit gjatë këtij viti, duke u bazuar në të dhënat e fundit që i kemi në dispozicion për sektorët përkatës.

Ekonomia e Kosovës e filloi vitin 2022 me një perspektivë mjaft të mirë, duke qenë se po linim pas një vit mjaft të suksesshëm, ku sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, **norma reale e rritjes së Bruto Produktit Vendor në vitin 2021 ishte 10.75 përqind.**

Megjithatë, gjatë vitit 2022, ndryshimi i dinamikave globale si pasojë e luftës në Ukrainë, që u shoqëruan me rritje të inflacionit, ndryshim të politikave monetare dhe rritje të normave të interesit dhe ngadalësim të rritjes së tregtisë botërore si rezultat i ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit, u reflektua edhe në aktivitetin ekonomik në Kosovë. **Sipas vlerësimeve të BQK-së, BPV-ja në 2022 pritet të shënoj rritje të ngadalësuar prej 3 deri në 4 përqind,** kryesisht për shkak të tkurrjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së importit, ndërsa eksportet kanë ndikuar pozitivisht.

Bazuar në të dhënat e regjistruara deri me shtator të këtij viti, **shpenzimet e jorezidentëve** në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave janë nga diaspora, ishin në shumë prej **1.48 miliardë euro**, e cila paraqet një **rritje prej 26.1 përqind** në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Po ashtu, viti 2022 shënoi një ritëm më të shpejtë të rritjes edhe për remitencat e dërguara nga diaspora në Kosovë. Vlera e **remitencave** të pranuar deri në fund të muajit tetor 2022 është **1 miliardë euro**, që paraqet rritje vjetore prej **5.5 përqind.**

Rritja e kërkesës së brendshme në Kosovë gjatë këtij viti u reflektua në një vlerë më të lartë të **importit të mallrave**, i cili deri në shtator 2022 shënoi vlerën **4.15 miliardë euro** apo një rritje vjetore **prej 24.6 përqind.** Në anën tjetër, **eksporti i mallrave** shënoi vlerën prej **688.0 milionë euro**, duke shënuar rritje vjetore prej **27.1 përqind.** Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, **deficiti tregtar** në llogarinë e

mallrave deri në muajin shtator 2022 regjistroi vlerën prej **3.47 miliardë euro**, që paraqet një rritje vjetore prej **24.2 përqind**.

Në anën tjetër, eksporti i shërbimeve deri në shtator 2022 shënoi vlerën prej **2.05 miliardë euro**, duke shënuar një rritje vjetore prej **32.8 përqind**, që ka ndodhur kryesisht si rezultat i rritjes së vizitave të bashkatdhetarëve tanë dhe turistëve në vend. Me rritje u karakterizua edhe importi i shërbimeve që deri më shtator 2022 regjistroi vlerën prej **901 milionë euro**.

Pra gjithsej importet e mallrave dhe shërbimeve deri në muajin shtator të këtij viti janë në shumë prej **5.05 miliardë euro**, ndërsa eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë në shumë rreth **2.7 miliardë euro**.

Për sa i përket investimeve të huaja direkte, vlera e tyre deri në shtator 2022 arriti në **567 milionë euro**, në krahasim me vlerën prej **395 milionë euro** të regjistruar deri në shtator 2021. Gjatë kësaj periudhe, rritje të lartë shënuan IHD-të tek investimet në patundshmëri, të cilat shënuan vlerën prej **394 milionë euro**, në krahasim me vlerën prej **265 milionë euro** të regjistruar deri në fund të shtatorit 2021, apo shprehur në përqindje, kemi një rritje prej **48.7 përqind**.

Për sa i përket treguesve tjerë makroekonomikë, vlen të theksohet se **mesatarja e inflacionit deri në nëntor 2022** shënoi normën prej **11.5 përqind** në krahasim me mesataren vjetore prej **3.4 përqind** për vitin 2021. Ndërsa, norma e inflacionit vetëm për muajin nëntor 2021 ishte **11.5 përqind**, gjë që tregon se po ballafaqohemi me një trend në rritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Rritja e normës së inflacionit në Kosovë kryesisht reflekton rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, të cilat në Kosovë transmetohen përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara.

Sa i përket sistemit financiar, është shumë e rëndësishme të theksohet se Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem financiar të shëndoshë, i cili jo vetëm se u

dëshmuar i aftë të përballojë krizat e shkaktuara nga pandemia dhe agresioni rus në Ukrainë, por edhe të marr një rol shumë të rëndësishëm në mbështetjen e ekonomisë për ta përballuar krizën me pasoja sa më të vogla që ishte e mundur. Gjithsej mjetet e sistemit financiar, me 30 tetor 2022 ishin në vlerë **prej 9.43 miliardë euro**, me një rritje vjetore **prej 10.2 përqind**.

Spektori bankar, si komponentë kryesore e sistemit financiar në vend, edhe këtë vit, po luan rol shumë të rëndësishëm në përkrahjen e ekonomisë së vendit duke vazhduar ritmin e rritjes së kreditimit dhe të ruaj shkallën e qëndrueshmërisë. Deri në muajin tetor 2022, vlera e **kredive të reja** të lëshuara nga sektori bankar ishte **1.59 miliardë euro**, që paraqet një rritje vjetore **prej 13.6 përqind**, përderisa vlera e përgjithshme e kredive aktive në sektorin bankar deri në shtator 2022 ishte **4.27 miliardë euro**, e cila paraqet një rritje vjetore prej **18.4 përqind**, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Vlen të theksohet posaçërisht cilësia e mirë e portofolit kreditor me një normë të **kredive joperformuese prej vetëm 2.0 përqind** në tetor 2022. **Mbulueshmëria e kredive joperformuese** me provizione për humbje nga kreditë mbetet në nivel të lartë prej **151.2 përqind**, që dëshmon për nivele adekuate të provizioneve në sektorin bankar.

Gjithsej mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë këtij viti, duke arritur vlerën prej **6.46 miliardë euro** në tetor 2022, e cila paraqet një rritje vjetore prej **12.4 përqind** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Spektori bankar vazhdon të gëzojë besim të lartë tek publiku, besim ky i shprehur edhe me rritjen e vazhdueshme të depozitave. Në tetor 2022, vlera e përgjithshme e depozitave ishte rreth **5.3 miliardë euro**, që paraqet një rritje vjetore prej **14.2 përqind**. Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga **depozitat e ekonomive familjare**, kategori që dominon strukturën e gjithsej depozitave në

sektorin bankar me pjesëmarrje prej **67.6 përqind** në totalin e depozitave, e të cilat deri në tetor 2022 shënuan rritje vjetore prej **11.5 përqind**.

Norma mesatare e interesit në kredi në tetor 2022 shënoi **6.2 përqind**, e cila është më e lartë në krahasim me normën prej **6.0 përqind** të regjistruar në tetor 2021. Ndërkohë që norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje nga **1.3 përqind sa ishte në tetor 2021 në 1.5 përqind në tetor 2022**.

Treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet.

Sektori bankar vazhdon të ketë tregues të lartë të **mjaftueshmërisë së kapitalit** prej **15.8 përqind** në fund të tetorit, që vazhdon të jetë dukshëm mbi nivelin minimal rregullativ prej 12.0 përqind.

Pozita e **likuiditetit** të sektorit bankar mbetet në nivel të lartë. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në korrik ishte **34.5 përqind**, që është lartë mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.

Sistemi i pagesave ndërbankare (SPN) i cili mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë, ka vazhduar funksionimin normal dhe pa pengesa.

Deri në muajin nëntor 2022 janë procesuar 15.8 milionë transaksione me vlerë totale mbi 14.7 miliardë euro. Krahasuar me transaksionet e vitit paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për afër 21.6 përqind, kurse vlera e transaksioneve është zvogëluar për 3.5 përqind.

Rritje të theksuar gjatë këtij viti kemi edhe në numër të transaksioneve në POS por edhe atyre në ATM të bankave. Numri i transaksioneve në POS deri në nëntor 2022 ka arritur në 23.5 milionë me një rritje prej 42.0 përqind, derisa numri i

transaksioneve në ATM ishte 18.1 milionë apo rritje prej 7.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Numri i llogarive në sektorin bankar, deri në nëntor ka arritur në 2.36 milionë, derisa numri i llogarive në e-banking është 676 mijë.

Zhvillime pozitive kemi edhe te sektori i sigurimeve. **Asetet e sektorit të sigurimeve**, që përfaqësojnë rreth 3.0 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në shtator 2022 shënuan vlerën prej **259.0 milionë euro**, duke shënuar rritje vjetore prej **10.0 përqind**.

Është e rëndësishme të theksohet që ekuiteti i sektorit të sigurimeve edhe këtë vit ka shënuar rritje, si rezultat i kërkesave të BQK-së për shtim të kapitalit. Vlera e ekuitetit të siguruesve në shtator 2022 ishte **66.4 milionë euro** me një rritje vjetore prej **8.7 përqind**.

Primet bruto të shkruara nga kompanitë e sigurimit deri në shtator 2022 shënuan vlerën prej **98.2 milionë euro** apo një rritje vjetore prej **13.0 përqind**, përderisa dëmet e paguara bruto shënuan vlerën mbi **42 milionë euro** apo një rritje vjetore mbi **25 përqind**.

Edhe sektori pensional gjatë këtij viti u karakterizua me rritje, krahasuar me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional në shtator 2022 arriti në **2.3 miliardë euro** krahasuar me **2.2 miliardë** sa ishin në shtator 2021, që përkon me një rritje vjetore prej **4.2 përqind**. Sektori pensional deri në shtator 2022 për shkak të kushteve jo të favorshme në tregjet financiare ndërkombëtare, shënoi performancë jo të mirë financiare, duke shënuar kthim negativ në investime në vlerë prej rreth 170 milionë euro. Kontributet e reja pensionale gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej rreth 177.5 milionë euro.

Sa i përket sektorit të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, deri në tetor 2022, **asetet e** këtij sektori arritën vlerën prej **386.1 milionë euro** duke shënuar rritje vjetore prej **12.6 përqind**.

Gjithsej kreditë aktive të këtij sektori në tetor shënuan vlerën prej **276 milionë euro**, apo rritje vjetore prej **18.4 përqind**.

Norma mesatare e interesit në kreditë e reja të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare në tetor ishte **19.0 përqind**, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte **20.6 përqind**. Edhe në këtë sektor vlerësohet cilësia e mirë e portofolit kreditor me një normë të **kredivë joperformuese prej 2.9 përqind**.

BQK-ja ka vazhduar angazhimin e saj edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, duke i shërbyer kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjes së interesit të qytetarëve. Deri në muajin nëntor të këtij viti, numri i ankesave të shqyrtuara nga ana e BQK-së ka arritur në 810 ankesa. Angazhimi i BQK-së në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, qoftë përmes programeve të edukimit financiar, qoftë përmes masave korrektuese ndaj institucioneve financiare, ka qenë dhe do të mbetet prioritet i BQK-së edhe gjatë viteve të ardhshme.

Për sa i përket zhvillimeve të brendshme, BQK-ja edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar me avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të saj profesionale në të gjitha fushat e veprimit të saj.

Përkundër situatës së krijuar dhe kushteve jo shumë të favorshme në tregjet ndërkombëtare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur të ruajë

qëndrueshmërinë e saj financiare dhe performancën e mirë të institucionit, duke gjeneruar rezultat financiar pozitiv.

BQK-ja mbetet e përkushtuar që të vazhdojë aktivitetin e saj në shërbim të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit, duke krijuar kushtet për zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme financiare, në linjë me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë, duke përfshirë edhe zhvillimin e segmenteve të reja të sistemit financiar siç është tregu i kapitalit, i cili kërkon një bashkëveprim të gjerë ndërinstitucional.

Gjithashtu këtë vit, sikurse jeni në dijeni, Republika e Kosovës ka fituar arbitrazhin ndërkombëtar ndaj institucionit financiar Iute Credit. Ky rast dëshmon qartë që BQK-ja ka qenë dhe mbetet e sigurve në ligjshmërinë e vendimeve të saj, jo vetëm në raport me këtë institucion, mirëpo kundrejt secilit institucion që ushtron aktivitet financiar në vend. Gjatë viteve të fundit janë revokuar 14 licenca/regjistrime të institucioneve financiare dhe të gjitha rastet në gjykata kanë pasur epilog pozitiv për BQK-në.

Duke shpresuar dhe besuar se viti i ardhshëm do të jetë një vit më pozitiv në të gjitha aspektet, ju uroj shumë shëndet, gëzime dhe suksese të gjithë juve dhe familjeve tuaja.

Të nderuar përfaqësues të mediave, për fund më lejoni të ju informoj se BQK-ja në kuadër të Funkcionit të përgjithshëm të saj nga fusha e edukimit financiar si komponent e veçantë dhe me qëllim të nxitjes së hulumtimeve në fushën e ekonomisë në mesin e të rinjve të Kosovës, ndanë çdo vit çmimin tradicional për “Ekonomistë të Rinj”.

Këtë vit tema e Konkursit për Çmimin “Ekonomist i Ri“ ka qenë: “Ndikimi i inflacionit në Tregtinë Evropiane dhe atë të Kosovës”

Komisioni profesional ka vlerësuar tri punime më të mira nga studiues të rinj.

Ftoj studenten **Njomza Jupa** nga Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë

Ftoj studenten **Anisë Murseli** nga “Yale University” i SHBA-ve

Ftoj studenten **Rozafa Hajdari** nga Universiteti “Haxhi Zeka“ në Pejë.